

KERKESE PER OFERTE

Projekti: “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike” 2024-2025

Instituti i Studimeve Politike (ISP), është duke implementuar projektin “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike” 2024-2025, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) organizatë lider, në partneritet me BIRN Albania dhe Qëndresa Qytetare (QQ). Ky projekt mbështetet financiarisht nga Ambasada Britanike.

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në parandalimin dhe shfaqjen e ndikimeve të panevojshme përmes angazhimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin, si dhe përmes informimit të një grupi të rëndësishëm të aktorëve dhe palëve të interesuara për të siguruar implementimin e drejtë dhe të lirë nga ndikimet e panevojshme në procesin zgjedhor.

Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të projektit ISP do të organizojë 4 open forume për zhvillimin e të cilave kërkohet për efekt promovimi dhe sensibilizimi prodhimi i *Setit promociional* me logo dhe objektiva të projektit për pjesëmarrësit në këto open forume.

ISP shpall thirrjen publike për pjesëmarrje në tenderin për prodhimin e *Setit promociional* me logo dhe titull të projektit, për produktet e listuara si më poshtë:

1. Dosje
2. Blloqe
3. Stilolapsa

Subjektet janë të lutur të japin ofertat e tyre për furnizimin me materialet e mësipërme për të cilat do të ketë procedurë vlerësimi dhe do të lidhet kontratë me ofruesin më të mirë. Ato duhet

të kenë eksperiencë në fushën e grafik - dizajnit, konceptimit të formatit, përgatitjes dhe printimit të materialeve promocionale etj.

Ftohen ato subjekte të interesuara që përmbushin kriteret dhe kushtet e mëposhtme:

- Të jenë të regjistruara pranë QKB;
- Të ofrojnë shërbimin Grafik & Dizajn: realizim , konceptim , përgatitje, prodhim/ printim;
- Të jenë fleksibël deri në variantin final dhe të ofrojnë garanci për dorëzimin e materialit brenda afatit dhe sipas specifikave teknike;
- Çmimi të përfshijë TVSH -në;
- Fatura pranohet vetëm e fiskalizuar;
- Preferohen subjekte të licencuar me objekt veprimtarie në përputhje me shërbimet e kësaj kërkesë për ofertë;
- Preferohen subjekte që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në Tiranë.

Specifikimet teknike

- Dosje shtypi 4 color, format 32 cm x 23cm, me xhëp ,me plastifikim - sasia 160 copë,
- Blloqe format A5 fletet e brendshme printim color shtypi me ngjyra, kapaku color 4 me plastifikim, lidhje spirale- sasia 160 copë
- Stilolapsa – printim Uv- sasia 160 copë

Materiali i brendshëm do të realizohet në bashkëpunim me ISP.

Subjektet e interesuara të dërgojnë:

- Ofertë financiare ***e paraqitur në GBP, duke përfshirë TVSH,***
- Punë (produkte) të ngjashme
- Certifikatën e regjistrimit në QKB/ose ekstrakt

Aplikimi duhet të dërgohet në një nga variantet, jo më vonë se data 25/09/2024 ora 16:00:

- në formë elektronike në adresën e e-mail:contactaips@gmail.com ose contactaips@isp.com.al
- me postë në adresën: Rr. "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap. 16, Tiranë/ ose dorazi me zarf të mbyllur pranë zyrave të ISP me mbishkrimin - *Ofertë prodhim seti promocional,* nr. kontakti dhe adresë e saktë.
- Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rremë e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

Vetëm subjekti i përzgjedhur do të lajmërohet.

Instituti i Studimeve Politike